



Gjetjet kryesore të Raportit 2019 për Shqipërinë

Bruksel, 29 maj 2019

Kriteret politike

Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres me agjendën e saj të reformave në BE gjatë gjithë periudhës raportuese. Polarizimi i fortë ka vazhduar në sferën politike. Veprimtaritë parlamentare janë ndikuar nga një bojkot i zgjatur i partive të opozitës, të cilat pastaj hoqën dorë *en bloc* nga mandatet e tyre parlamentare në shkurt të vitit 2019. Më shumë se gjysma e mandateve të refuzuara parlamentare tani janë ricktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe kuorumi për funksionimin e plotë të Kuvendit është ruajtur. Partitë kryesore të opozitës vendosën të mos regjistrohen për zgjedhjet vendore, të cilat planifikohen të bëhen më 30 qershor 2019. Tërheqja e partive kryesore të opozitës ka ndikuar negativisht në përpjekjet për një reformë zgjedhore dypalëshe, pavarësisht nga përpjekjet e shumicës për të ecur përpara. Partitë e opozitës duhet të ri-angazhohen në mënyrë konstruktive në institucionet demokratike.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në atë që ka të bëjë me reformën e **administratës së saj publike**. Përpjekjet kanë vazhduar në disa fusha lidhur me këtë, duke rezultuar me njëfarë progresi në efikasitetin dhe transparencën e ofrimit të shërbimeve publike, përmirësimin e kuadrit rregullator mbi vlerësimin e ndikimit të politikave, procedura më transparente të rekrutimit dhe forcimin e përgjithshëm të kapacitetit të administratës për të ndërmarrë procedura të shërbimit civil të bazuara te meritat. Konsolidimi i këtyre arritjeve duhet të përparojë më tej, për të siguruar një administratë publike më efikase, të depolitizuar dhe profesionale.

Sistemi gjyqësor i Shqipërisë ka njëfarë niveli përgatitjeje. Zbatimi i reformës gjithëpërfshirëse dhe të plotë të drejtësisë ka vazhduar me qëndrueshmëri, duke rezultuar me përparim të mirë në përgjithësi. Janë krijuar institucionet e reja për vetëqeverisjen e gjyqësorit - Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli për Emërimet në Drejtësi - duke përfaqësuar një hap vendimtar në forcimin e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Rivlerësimi i përkohshëm i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetingut) ka përparuar vazhdimisht, duke prodhuar rezultate të prekshme. Me mbështetjen e Komisionit Evropian, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka vazhduar ta mbikëqyrë procesin. Më shumë se 140 dosje janë përpunuar, duke rezultuar me 88 shkarkime / dorëheqje të magjistratëve nga detyra dhe 53 konfirmime. Shumica e shkarkimeve kanë të bëjnë me çështjet që lidhen me pasuritë e pajustificuara. Këto rezultate konkrete dhe të besueshme e kanë forcuar ndjeshëm sektorin dhe kanë konsoliduar pavarësinë, paanësinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien e gjyqësorit.

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në **luftën kundër korrupsionit**. Është bërë progres i mirë, sidomos me miratimin e Planit të ri të Veprimit 2018-2020 për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, ndryshimeve në Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, Ligjin mbi Prokurimin Publik, si dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për anëtarët e Kuvendit. Themelimi i një Task Force kundër Korrupsionit ka rritur proaktivitetin e hetimeve administrative. Qasja e drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave për prokurorët dhe policinë ka vazhduar të përmirësohet. Progresi i mirë ka vazhduar përmes forcimit të historikut të hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit në nivel të lartë. Rezultatet konkrete në luftën kundër korrupsionit përfshijnë procesin e vetingut që ka çuar në shkarkimin nga detyra të një numri magistratësh të rangut të lartë, duke përfshirë edhe në nivelin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Themelimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) lejoi fillimin e themelimit të organeve të specializuara anti-korrupsion (Struktura e Posaçme e Antikorrupsionit dhe luftës kundër Krimit të Organizuar - SPAK, Byroja Kombëtare e Hetimeve - BKH). Pas përfundimit të vetingut të kandidatëve, organet do të bëhen operative, çka do të forcojë kapacitetin e përgjithshëm për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin. Megjithatë, në përgjithësi, korrupsioni është mbizotërues në shumë fusha dhe mbetet një çështje shqetësuese.

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në **luftën kundër krimit të organizuar**. Operacionet policore për shkatërrimin e organizatave kriminale janë intensifikuar. Disa operacione policore rezultuan me arrestime të shumëfishta dhe një numër padish dhe dënimesh të rëndësishme janë kryer. Këto operacione kanë rezultuar me arrestimin dhe ndjekjen penale të udhëheqësve të njohur të grupeve kriminale të organizuara. Bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë, veçanërisht me Shtetet Anëtare të BE-së, gjithashtu është intensifikuar, duke çuar në një numër operacionesh të suksesshme të zbatimit të ligjit në shkallë të gjerë. Vazhdimisht gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka treguar një angazhim të fortë për të luftuar prodhimin dhe trafikimin e kanabisit. Shqipëria lejon futjen e një mekanizmi ndërhyrës të monitorimit nga një Shtet Anëtar i BE-së (monitorimet ajrore nga Guardia di Finanza italiane, bashkëfinancuar nga BE-ja). Gjatë dy sezoneve të kaluara të të korrave, mbikëqyrja ajrore ka vërtetuar se pothuajse nuk ka pasur kultivim të kanabisit në Shqipëri. Këta hapa paraqesin progres të prekshëm në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të fundit për përmirësimin e historikut. Përpjekjet duhet të vazhdojnë, veçanërisht duke trajtuar pastrimin e parave dhe duke konfiskuar pasuritë që burojnë nga krimet dhe pasuritë e tjera të pajustificuara

Për **të drejtat themelore**, Shqipëria në përgjithësi pajtohet me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e vet ligjor në përputhje me standardet evropiane. Gjatë periudhës raportuese, Shqipëria ka bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare. Megjithatë, zbatimi i përgjithshëm i këtyre instrumenteve mbetet për t'u forcuar. Kuadri ligjor është përmirësuar në fushat e të drejtave të fëmijëve dhe dhunës në familje. Në maj 2018, Kuvendi miratoi një ligj të ri mbi strehimin social, i cili synon të forcojë mbrojtjen e të drejtës për strehim të pjesëtarëve më të cenueshëm të komuniteteve romë dhe egjiptiane [1]. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me konsolidimin e të drejtave pronësore. Sa i përket **lirisë së**

shprehjes, mjedisi i përgjithshëm legjislativ është i favorshëm për ushtrimin e lirisë së shprehjes, por zbatimi kërkon përpjekje të mëtejshme.

Sa i përket **marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal**, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë aktive në bashkëpunimin rajonal dhe të mbajë marrëdhënie të mira fqinjësore. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të trajtuar çështjet bilaterale me Greqinë.

Në lidhje me **migracionin**, është bërë njëfarë përparimi në përmirësimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e kufirit dhe azilit. Në tetor 2018 Shqipëria nënshkroi me BE-në Marrëveshjen Status për Rojat Evropiane Kufitare dhe Bregdetare. Kapaciteti pritës për t'u marrë me flukset migratore të përziera është zgjeruar më tej. Numri i aplikimeve të pabazuara për azil të paraqitura nga shtetasit shqiptarë në BE ka rënë, por mbetet i lartë dhe kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, si dhe trajtimin e fenomenit të të miturve të pashoqëruar.

Kriteret ekonomike

Shqipëria ka bërë njëfarë përparimi dhe është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Zhvillimi ekonomik u rrit më tej dhe papunësia ka rënë, por mbetet ende e lartë. Eksportet u rritën në mënyrë të qëndrueshme dhe deficitet i llogarisë rrjedhëse është ngushtuar. Raporti i lartë i borxhit publik ndaj PBB-së vazhdoi të ulët, por ritmi i konsolidimit fiskal mbeti i ngadalshëm. Bankat kanë vazhduar ta ulnin numrin e kredive joperformuese dhe përdorimin e monedhës së huaj. Sektori bankar mbeti i qëndrueshëm, ndonëse rritja e kreditimit të biznesit nuk u përmirësua. Janë ndërmarrë hapa drejt zhvillimit të tregut financiar. Mjedisi i biznesit është përmirësuar vetëm në disa aspekte. Progresi në zbatimin e reformës gjithëpërfshirëse të drejtësisë pritet të kontribuojë për forcimin e mjedisit të biznesit dhe tërheqjen e investimeve. Është bërë njëfarë përparimi në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës, por shkalla e punësimit dhe pjesëmarrja në tregun e punës mbeten të ulëta dhe ekonomia joformale është ende një ofruese e rëndësishme e vendeve të punës.

Shqipëria ka bërë njëfarë përparimi dhe ka njëfarë nivel përgatitjeje sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian. Shqipëria ka bërë njëfarë përparimi në drejtim të zhvillimit të energjisë, transportit dhe infrastrukturës digjitale, por mungesa e njohurive produktive, nivelet e ulëta të arsimit dhe transferimet teknologjike pengojnë konkurrencën dhe integrimin e Shqipërisë në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare. Eksportet dhe integrimi rajonal janë nën potencial. Përpjekjet për përmirësimin e arsimit dhe trajnimit tregojnë disa rezultate, por reformat duhet të vazhdojnë, në veçanti për të adresuar më mirë zonat rurale dhe grupet e cenueshme. Kapaciteti i Shqipërisë për kërkime, zhvillim dhe inovacion mbetet shumë i ulët.

Legjislacioni i BE-së

Shqipëria ka vazhduar ta përshtatë legjislacionin e saj me kërkesat e BE-së në një numër fushash, duke rritur **aftësinë për të ndërmarrë detyrimet e anëtarësisë**. Vendi është mesatarisht i përgatitur në shumë fusha, të tilla si kontrolli financiar,

arsimi dhe kultura dhe statistikat, ose ka njëfarë niveli përgatitjeje, duke përfshirë në fushat e prokurimit publik dhe rrjeteve trans-evropiane. Shqipëria do të duhet t'i vazhdojë përpjekjet e saj lidhur me përgatitjet e përgjithshme për të miratuar dhe zbatuar *acquis* e BE-së. Miratimi i një politike gjithëpërfshirëse të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe koordinimi i zbatimit të saj me reformat e vazhdueshme të administratës publike dhe menaxhimit të financave publike mbetet çelësi drejt një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. Shqipëria duhet të vazhdojë punën për zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë, si dhe masat përkatëse të reformës së ndërlidhjes, edhe me qëllimin e përmirësimit të ndërlidhjes në të gjithë rajonin.

Kapaciteti administrativ dhe standardet profesionale të organeve të ngarkuara me zbatimin e *acquis* duhet të forcohen dhe të ruhet pavarësia e organeve rregullatore. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, në veçanti duke siguruar funksionimin efektiv, efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike, mbetet thelbësore. Shqipëria ka vazhduar të përafrohet plotësisht me të gjitha pozicionet dhe deklaratat e përbashkëta të politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Të dhënat kryesore

Qershor 2003: Samiti i Selanikut BE-Ballkani Perëndimor konfirmon perspektivën e BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Qershor 2006: Nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.

Prill 2009: Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri hyn në fuqi. Shqipëria paraqet kërkesën e saj për anëtarësim në BE.

Nëntor 2010: Komisioni Evropian nxjerr Opinionin e tij mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësimin në BE, duke përfshirë një grup prej 12 prioritetesh kryesore që duhet të përmbushen në funksion të hapjes së negociatave të anëtarësimit.

Dhjetor 2010: Udhëtimi pa viza në zonën Schengen për qytetarët e Shqipërisë.

Qershor 2014: Këshilli Evropian i jep Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE.

Shkurt 2018: Komisioni Evropian miraton strategjinë e tij për "Një perspektivë të besueshme për zgjerimin dhe përforcimin e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor".

Prill 2018: Komisioni Evropian rekomandon që Këshilli të vendosë hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë në dritën e progresit të arritur, duke ruajtur dhe thelluar vrullin aktual të reformës.

Qershor 2018: Këshilli përcakton rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit me vendin, varësisht nga përparimi i arritur.

Maj 2018: Samiti i Sofjes BE-Ballkani Perëndimor konfirmon perspektivën evropiane të rajonit dhe përcakton një numër veprimesh konkrete për të forcuar bashkëpunimin në fushat e ndërlidhjes, sigurisë dhe shtetit ligjor.

Maj 2019: Komisioni Evropian rekomandon hapjen e negociatave për anëtarësim.

Për më shumë informacion

[Raporti Shqipëria 2019](#)

[Paketa e Zgjerimit 2019](#)

[1] Në përputhje me terminologjinë e institucioneve evropiane, termi ombrellë "rom" është përdorur këtu për t'iu referuar një numri grupesh të ndryshme, pa mohuar veçoritë e këtyre grupeve.

Vendi/19/2775

Kontaktet e shtypit:

[Maja KOCIJANCIC](#) (+32 2 298 65 70)

[Alceo SMERILLI](#) (+ 32 2 296 48 87)

Pyetje të përgjithshme: [Europe Direct](#) me telefon [00 800 67 89 10 11](#) ose me [email](#)